

INTERVISTË ME XHAFER PECI

Stantërg | Data: 21 tetor, 2020
Kohëzgjatja: 72 minuta

Të pranishëm:

1. Xhafer Peci (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Renea Begolli (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë te komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zotri Xhafer nëse mundeni me u prezentu edhe me na tregu diçka për prejardhjen, familjen e ju?

Xhafer Peci: Po, unë jom Xhafer Peci. Jom i lindun me 12. 5. 1958 në fshatin Boletin në një familje të varfun si edhe familjet tjera atje. Shkollën fillore e kom kry në Boletin. Katër vjet i kom kry në Kullën e Isa Boletinit. Ka qenë shkollë, mandej e kanë punu edhe një shkollë, kryesore tetë vjet i kemi kry në Boletin. Gjimnazin atëherë e kemi vazhdu në Mitrovicë edhe Fakultetin Teknik, dega e Xehtarisë e kemi... e kom kry në Mitrovicë ku edhe aty kom diplomu në Mitrovicë.

Po thom jemi konë një familje e varfun. Babëgjyshi atëherë s'ka pasë as pune as penzion, baba e ka pasë një penzion shumë të vogël. Na jena shkollu në kushte mjaft të vështira. Babëgjyshi në atë kohë ka shpia nuk u konë punëtorë, por ka lufta kur ka pasë nevojë për me luftu për Kosovë babëgjyshi u konë, atje u konë. Prej që ka qenë ushtar i Bajram Currit, mandej me Azem Bejtën. Kur knohet kanga e Azem Bejtës e knojnë edhe babëgjyshin. Mandej me Ahmet Selacin kanë luftu, Boletini edhe Zhazha e kanë nisë t'parët pushkën kundër Draza Mihajloviqit¹ në Zhirovnicë dhe në Vallq edhe kanë vazhdu për anej e kanë çliru Pazarin e Ri edhe kanë vazhdu te një "Xherxhovi Stuba" i kanë thonë e kanë hi në Rashkë. Në Rashkë nuk i kanë lonë me hi edhe jonë kthy knej. Kanë luftu kundër partizanëve katër vjet. Katër vjet kanë nejt në mal, në bunkera, në majdan nëpër Shalë kanë luftu kundër partizanëve.

E kom pytë, "Babëgjysh për çka keni luftu?" Tha, "Kemi luftu me rrnue krejt shqiptarët në një dërzhavë². Por atëherë", tha, "luftën tonë s'patë kush na e mbron në tavolinë, na e shpallën atëherë kundër sistemit ballist edhe nuk na ndihmoi kërkush edhe u shpartallu. U harru lufta jonë". E me këto po du me thonë që gjeneratë pas gjenerate kanë luftu, kanë vujtë, jonë përsekutu vetëm e vetëm që Kosova të jetë e lirë, të mos jetë në dorë të serbëve, të Serbisë. Ka luftu tonë kohën.

¹ Dragoljub "Draža" Mihailović (1893-1946) ishte një gjeneral serb jugosllav gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai udhëheqi banda guerillash të njohura si Çetnikët e Ushtrisë Jugosllave.

² Srb.: *država*, shtet, vend.

Mas lufte as nuk ka deshtë me hi n'punë. Kur i thojshim, kur i kanë thonë, “Qerim”, Qerim Peci u konë, “Qerim, kqyr bre, me kqyr naj ndihmë, naj pomoq³”, atëherë i kanë thonë. “Jo”, ka thonë, “nuk e du. Kom luftu kundra tij, nuk e kom pranë si shtet, nuk e pranoj si shtet as tash as hiç edhe pa u bo Kosova e lirë une kto... Ky nuk o shtet as pushtet i jemi”. Edhe s'ka deshtë, as te mjeku s'kena mujt me çu. “Nuk ja du as parën as barnat e tijna”. Na tani, unë masi e kom kry fakulltetin, kom diplomu me 6 maj 1983 edhe me 6 qershor 1983 ja kom fillu punës në Stantërg si inxhinier i diplomum i xehtarisë.

Anita Susuri: Para se me vazhdu aty po du edhe pak me ju pytë për fëmijërinë. Baba juj, a ka qenë edhe ai xehtar apo është marr me...

Xhafer Peci: Jo, baba nuk ka qenë xehtar, ka qenë punëtor në një organizatë atëherë i thojshin, “Shpërplloqa”, qashtu u thirrë. Kanë qenë rrogat super të dobta, sa që s'kena mujt për bukë t'gojës me sigurie. Mandej ajo u mbyll, i qitën njëfarë penzioni të detyrueshëm. Ka qenë atëherë kategoria e parë, e dytë e penzioneve, ky ka qenë një kategori të tretë, një kurgjo hiç edhe qashtu. Kemi jetu në Boletin, e kemi punu tokën, jemi angazhu, i kemi ndihmu babës edhe shkollën edhe tokën e kemi punu vetëm e vetëm me mbijetu.

Korab Krasniqi: Sa vllazën e motra jeni konë?

Xhafer Peci: Po jemi tre vllazni edhe një motër. Vllau i tretë edhe ai ka të krym Fakulltetin e Gjeologjisë. Vllau i dytë nuk ka kry, vetëm Shollën e Mesme, edhe jeton osht' në Holandë. Ndërsa na jemi këtu, nuk jemi në Boletin, jemi qatje në Iliridë jetojmë, por shkojmë shpesh, shkojmë në Boletin, shkojmë shpesh. Jonë bo kushtet qitash, pushteti jonë, qeveria jonë, njerëzit tonë i kanë bo kushtet në Boletin. Prej tri-katër anëve shkon, osht' asfaltit, osht' ujësjellësi, osht' rryma edhe jonë kushtet shumë të mira për njerëzit që edhe kanë fillu kadal dikush dikush veç edhe me kthy kryt për anej.

Korab Krasniqi: E nanën prej kahit e ki pasë?

Xhafer Peci: Nanën e kom pasë të Vinarcit. Vinarci edhe ai në pjesën pak ma ka drejtimi i liqenit {tregon me duar} të Ujmanit atje, Vinarci atje, Qabra e anej jonë në atë pjesën anej.

Anita Susuri: Mu dukë shumë interesant që thatë shkolla ka qenë në Kullën e Isa Boletinit. A po ju kujtohet si keni shku edhe qysh ka qenë ajo kulla? Qysh ka qenë mësimi?

Xhafer Peci: Edhe gjeneratat ma herët kanë mësu në Kullën e Isa Boletinit, në kullën e sotshme që osht'. I kena pasë klasët jonë konë të adaptume ashtu edhe në atë kohë në Boletin jonë konë vetëm katër vjet, deri në klasën e katërt e mandej klasën e pestë e kanë vazhdu në Mitrovicë. Fatin na e kena pasë gjenerata e parë aty që e ndërtun edhe shkollën edhe vendosën që me konë shkolla tetë vjeçare

³ Srb.: *pomoć*, ndihmë.

në Boletin edhe ajo ke një ndihmë për Boletin, Zharzhë, Lipë. Ato tri katune i kanë qu nxansat në atë shkollë.

Anita Susuri: A u kanë taman si kullë? Po mendoj klasat qysh kanë qenë?

Xhafer Peci: Qikjo kulla e sotshme, qysh i kanë pasë ata dhomat, oda e burrave, dhoma tjetër, shpia, qato jonë bo klasë, n'qato kena msue edhe qaty qajo. Tani kur u ndërtu shkolla e re na kemi kalu anej edhe kulla qajo e sotit u metë gjithmonë.

Korab Krasniqi: Aty e keni një manastir të, manastir ortodoks. Qysh i keni pasë raportet? A ka pasë serbë në Boletin?

Xhafer Peci: S'po guxoj me folë se jemi tu inçizu (buzëqesh). Nuk i kena pengue, nuk i kena pengue, nuk i kena dëmtue, i kena respektue edhe i kena respektue ma shumë se që duhet edhe ma shumë se që e kanë meritue. Po foli me përgjegjësi të plotë edhe tash qaj nderim, qaj respektim i teprum neve na u ka kthye, na u ka hakmerrë kadal-kadale qysh na u ka hakmerrë ateherë edhe në luftën e mramë qitash prej... serbët, i kom thonë edhe një ditë një delegacioni amerikan qitu, serbtë ma s'pakti Kishat i përdorin për ceremoni fetare, ma s'shumti i përdorin për organizime kundër popujve tjerë. Prej qasaj kishe në Boletin jonë ardhë ekspeditat policore aty edhe prej atyhit jonë nisë jonë shku nëpër shpia në Boletin, në Zharzhë edhe i kanë malltretu gjinjën. Prej qatyhit i kanë tregu policisë ku jonë sot popullata e mshefne në mejdan, ku kanë qenë edhe sot 12-13 të Zharzhës jonë gjetë nëpër varreza masive.

Domethonë, kisha ka luft një rol shumë destruktiv, për rrethinën, atë rrethinë. Edhe osht' çudi, policia aty jonë ardhë edhe prej kishe qaq pozitën e ka që krejt Shala ose gjysa e Shalës i ka pa prej atyhit, krejt ka mujt m'i vrojtu, ka mujt m'i përcjell. Ajo Kishë, ata thojnë edhe ia ndrrojnë çdo detinim, se ajo kishe nuk osht' manastir. Ajo kishë u ndërtu diku në vitin 1850-60 e këta thojnë e shekullit të XV, këta thojnë e shekullit të XV. Tash e dijmë na që ka fol babëgjyshi jem me ata babëgjyshat asajde edhe kisha u ndërtu n'qatë kohë në tokën e babës të Isa Boletinit edhe qysh dijnë këta me tradhtu gjithkonin i kanë thonë, "Po i marojmë qitu, na e runë ky ktu e na vyn sa për kugjo hiç". Ajo tani tu u forcu pushteti i Serbisë ajo u shku edhe u zgjonu në dom të tokave të Boletinit, në dom të tokës të Isa Boletinit edhe në dom të të gjithëve u zgjonu ajo kishë. Sot e ka tash territorin t'vetin si Manastri i shekullit të XV, që ajo nuk ka t'boj më asnjë realitet. 1850-60 qaty qajo kishë u ndërtu si një vend me një gjys ari tokë edhe u metë n'qatë vend qaty edhe tani u zgjonu edhe ka bo sot gjithçka.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ju më tregut në ndërkohë që në Boletin jonë gjetë disa monedha, artefakte që kanë mbetë.

Xhafer Peci: Po, me gjasë fshati Boletin osht' vendbanim shumë i vjetër, osht' vendbanim historik edhe qysh na kanë përcjell gjyshërit tanë, në dy vende në Boletin kanë gjetë lira, ari të mshefta. Në vend i kanë gjetë tre kazana lira, një vend i kanë gjetë dy qypa, ksi enë të dheut t'mdhaja lira. Edhe sot e atë ditë ato vende nuk janë mbyllë, janë si gropa që mundet me i vizitu çdonjeri, mundet me shku me vërtetu çdokush që aty ka qenë një vendbanim atëherë. Ka pasë enë të dheut, ka pasë mallter, ka pasë tulla t'piqta, të forta, të mira edhe gjithmonë thonë që ka qenë vendbanim. Tani mandej sigurisht luftat e ndryshme, dyndjet e njerëzve, dergjja atje, ata gjinë nuk janë, janë zhdukë, nuk janë kthi edhe u mbetë ai vend, tani u mbeti si bosh.

Na Boletini edhe Zharzha jemi ardhë prej Izniqit. Prej Izniqit kemi ardhë edhe kemi kalu nëpër ato troje edhe sot e atë ditë na jemi në ato troje. Jena konë Boletini, Zharzha, jena konë gjithmonë në kufi me serbë. Gjithmonë ka pasë probleme. Qysh u formu pushteti serb, ata gjithmonë kanë bo presion, kanë bo shtypje, kanë bo zullum në ato vende anej. Edhe gjithmonë sa u nisë lufta kundër çetnikëve edhe Drazha Mihajloviqit, të parët ja kanë nisë Boletini edhe Zharzha aty luftës. E mandej ka mrrë edhe fronti edhe njerëzit prej Drenice, janë bo bashkë me Shaban Polluzhën e kanë vazhdu e kanë çlirue Pazarin, atëherë edhe e kanë kalu Pazarin e kanë njëkë ushtrinë e Drazha Mihajloviqit edhe deri te Rashka.

Mandej nuk i kanë leju me shku njerëzit tonë edhe u duht m'u kthi. Por qellimi kryesor ka qenë, se parulla e Drazha Mihajloviqit ish konë, "Me hi në Kosovë edhe dhjetë vjet e te naltë me i vra të gjithë, dhjetë vjet te poshtë me i marrë, me i shti në Serbi edhe me i asimilu ata gjind."

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ishit duke tregu për qypat edhe një tregim ke interesant për familjet që i kanë marrë ato paret.

Xhafer Peci: Ja qato s'pe foli hiç se ata janë një gojëdhanë që nuk jom i sigurtë.

Anita Susuri: Ani një gojëdhanë s'ka lidhje është diçka prej popullit që ka buru.

Xhafer Peci: Hiç s'pe foli, qato hiç s'pe foli.

Anita Susuri: Okej pra, po vazhdojmë. Shkollën e mesme, fillorën tregut që ka qenë në kullë edhe e keni vazhdu aty shkollimin. Pastaj shkollën e mesme ku e keni vazhdu?

Xhafer Peci: Po edhe një herë pe përsëris shkollën e mesme e kom kry, e kemi kry në Mitrovicë. Gjumnazi atëherë, "Silvira Tomazini" u thirrë gjumnazi. Ndërsa Fakultetin Xehtarë-Metalurgjik, dega e Xehtarisë e kom kry në Mitrovicë edhe ato për shkak të kushteve atëherë që s'kemi mujt me shku në

Prishtinë, se gjithmonë m'ka metë zhig mjekësia. A e kom pasë mirë a jo s'e di, por aty në kushte mjaft të vështira.

Anita Susuri: Tregoni qysh jeni udhëtu deri në Mitrovicë.

Xhafer Peci: Prej Boletinit jemi shku në magjistralen e Ibrit. Aty i ka pasë një gjashtë kilometra m'u lshu te poshtë të Boletini. Aty e kemi prit autobusin. E kemi pasë një mujore atëherë që qato e kemi pasë të sigurime prej familje edhe kemi shku në shkollë edhe në gjimnaz edhe në fakultet gjithmonë, tonë kohën kom udhëtu. Në mungesë të kushteve tonë kohën kom udhëtue.

Anita Susuri: Qysh ka qenë jeta gjatë periudhës së shkollës së mesme?

Xhafer Peci: Paj, atëherë normal në atë kohë i kemi pasë krejt profesorat shqiptarë. I kena pasë profesorat e mirë, kanë spjegu mirë, jonë mundu me çdo kusht që neve me na dhonë dituri. Me çdo kusht ata jonë mundu si m'u konë fëmijë t'vet. Edhe na shumica kena msu, shumica e atyne gjeneratave kanë kry fakulltetin, shumica e tyne jonë hi n'punë, por tani edhe në këto kushtet tjera shumë edhe jonë dalë jashtë, jonë në tjera shtete. Ka qenë një shkollë e mirë, i ka tubu nxanësat e mirë edhe prej asaj shkolle gjithmonë nxanësat kanë kry fakulltete.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Mitrovica në atë kohë?

Xhafer Peci: Paj Mitrovica në atë kohë ma s'pari ka qenë e bashkume edhe ma e pandërtume, asnjë fshat rrugë nuk ka pasë, ujësjellës nuk ka pasë. Gjithmonë njerëzit për me shku n'shollë edhe n'punë u duht me udhëtue, kush cili fshat ma shumë e ma pak por gjithmonë u duht me udhëtue deri ku e merr autobusi për me shku n'shollë apo n'punë. Domethonë, verë-dimër kanë udhëtue edhe kushtet e shtira kanë qenë.

Anita Susuri: A ka pasë ku me dalë ose naj organizim shoqëror ose kulturor?

Xhafer Peci: Paj nuk e di, na tash prej fshatrave ma shumë e kena pasë gajle mësimin edhe prej mësimi autobusin. U duht prej klase me dal ma i pari me shku me nxon autobusin e fundit edhe me ecë. Ndërsa qyteti kush u konë kanë dalë në mramje kanë shetitë, kanë shetitë një shesh u konë asajde ka Ura e Ibrit. Kanë shetitë qaty deri në dhjetë, njëmbdhjetë edhe njerëzit jonë shkep, jonë shku në shpia t'veta. Nuk ka pasë ma tepër, nuk ka pasë ma tepër se qajo shetitje nuk ka pasë ma tepër.

Anita Susuri: Ju m'tregut se kur keni qenë student, domethonë kanë qenë vitet edhe ju ka nxonë demonstratat e vitit '81 edhe keni marrë pjesë bashkë me babën. A mundeni me m'tregu ma shumë rreth qasaj?

Xhafer Peci: Po, çdo njeri, çdo person por edhe nëpër fshatra në oda, gjithmonë e kanë bisedu edhe pleqët, por e kanë bisedu edhe do që jonë kanë pak ma t'ri. Gjithmonë u bisedu liria e Kosovës, liria e popullit të Kosovës, vendi i Kosovës, Kosovën me udhëheq shqipëtarët, m'i sundu shqiptarët, me zhvillu shqiptarët. Gjithmonë u fol edhe tash gjithmonë i kemi pasë ato ndjenja që duhet m'u bo diçka. Çka shumë nuk dijsim, por duhet m'u bo diçka që secili mu kanë Zot i shpisë ne vend t'vetin. Kurrë as ata atëherë nuk kanë tentu me thonë, "T'jom Zot i shpisë une n'territore të tyne, por i Zot i shpisë m'u kanë n'vendi t'vetin" edhe na tash edhe pak kanë m'u kanë aso atje qysh kanë përjetu populli ma herët edhe domethonë veç tetonë jonë rritë n'qatë ide.

E dijsim që don me ardhë puna diçka m'u nis, u nisën demonstratat e '81-shit në pranverë edhe tash si tetonë njerëzit që kanë marrë pjesë në demonstrata edhe unë me babë temin në demonstrata. Atëherë katër prilli ka qenë në Mitrovicë. A po don tenka, a po don autoblanda, a po don polici të tana anëve, punon qashtu për demonstrata. Për çka? Veç e veç që m'u kanë Kosova e lirë, m'u kanë populli shqiptarë i barabartë me popujt tjerë, as ma shumë as ma pak. Nuk kena deshtë me dominu, nuk kena deshtë m'i shkel kërkonë, me ia cënu lirinë kërkujt, por kena deshtë me fol, me luftu për liri tonën edhe qysh e dini tani mo prej '81-shit secila ditë ma e keqe se tjetra u kanë.

Anita Susuri: A mundeni me ma përshkru pak çka keni pa qatë ditë? A ka pasë naj ngjarje diçka konkrete?

Xhafer Peci: Gjithçka. Në hallakamë nuk mundesh me dallu shumë sende. Nuk dijshe a ma shumë këtu a aty a aty. Tenkat, autoblandat, policia, njësitë speciale, populli, tim, ndiq këto anej anej, gjuju me ta. Domethonë, krejt kohë e dhunës, kohë e dhunës pse shqiptarët po dojnë m'u kanë të barabartë me tjerët, kurgjo s'ka pasë aty.

Anita Susuri: A e keni vrejt pastaj që u përkeqësu situata në shoqëri kështu edhe me njerëz?

Xhafer Peci: Jo, ato ngjarje, ajo dhunë e atëherëshit popullin e ka bashkue si kurrë ma parë edhe atëherë prej atyne ngjarjeve nuk ka pasë mo dallim, ky qytetar, ky katunar, ky i varfur, ky i pasur, ky krejt. Ajo dhunë i ka bo pupullin njo edhe i ka bo popullin njo edhe i ka bashkue edhe i ka vllaznue popullin si kurrë ma parë. Edhe gjithmonë kanë thonë, "Kur t'ju flugsh një grupi të njerëzve me i mytë, ata kanë m'u bashkue". Kanë m'u bashku m'u mbrojtë edhe qashtu.

Anita Susuri: Pas përfundimit të fakultetit, në cilin vit po i bjen që e keni përfundu?

Xhafer Peci: Po në fakultetin, unë kom diplomu me 6 maj 1950 e, jo...

Anita Susuri: '83?

Xhafer Peci: Jo, po '83-tin, ndërsa punës ia kom fillu tamon një muj ma vonë me 6 qershor '83-tin ia kom nisë punën këtu si inxhinier i diplomum i xehtarisë. Kemi punu, i kemi pasë këtu te tona nacionalitetet. Edhe një herë ndoshta në këtë intervistë e kom cek, i kena respektue, i kena nderue edhe i kena bo një respektim të teprum edhe ka ndodhë në mbledhje për një serb a dy a tre ndoshta, tridhjetë shqiptarë kanë folë serbisht vetëm e vetëm mos m'u ndi ata të diskriminim. Edhe një banes me nda diçka, "Hajt mos i përjashto, mos t'ndihen që ku janë veç që janë pakicë e ju ka dhënë atje krejt". Po tash, ai respekti i teprum neve na u ka kthyer në anën e kundërt, na u ka kthyer në dëm tonin.

Ka qenë inxhinier qitu serb e ka marrë prej shkollës teknike para penzionit për vetëm e vetëm me ju rrit rroga, me ju rrit penzioni edhe s'ka punu kurgjo, veç u sill qasajde. Kur erdh puna kundër shqiptarëve u bo një organizator shumë i fortë ai plaku atëherë, shumë u bo një organizator i fortë kundër shqiptarëve... Edhe fillun tani m'i nda punëtorët serbë m'u nda, filloi ndamja kadale. Edhe diçka me ju tregu, miniera o punë e zorshme, punë e rondë. Besoni me përgjegjësi të plotë po ju thom që krejt barrën e t'rrezikut e t'punës e t'zorit e kanë pasë inxhinierat shqiptarë. Inxhinierat serbë te tonë janë konë në vende ma t'lehta, punëtorët serbë janë konë në vende ma t'lehta, në vende ma t'sigurta, në vende ma t'lehta. Por, përsëri ata nuk e kanë pasë qëllimin as t'punës as krejt, por qëllimin knej me marrë me sundu Kosovën, krejt u konë qëllimi qaty edhe për qata s'i ka lonë ai vendi aty, s'i ka lonë ajo idea e tyre rahat, i ka qupurit gjithmonë.

Anita Susuri: Ju thatë që është punë e vështirë me punu në minierë edhe e besoj se po. Si ka qenë për juve hera e parë kur keni hi në zgafellë? Çfarë ndjenje keni pasë?

Xhafer Peci: Paj, na, atëherë si t'ri, si inxhiniera të diplomum, unë e kom zgjedhë minierën, e kom zgjedhë xehtarinë edhe gjithmonë nuk kom pritue se e kom zgjedhë vet. E kom zgjedhë vet edhe kolegët e mi qashtu, e kena zgjedhë vet e kena përcaktu për këtë lami edhe ju kemi nënshtr punës. Kemi punu, u dalë në xehe këtu, u dalë prodhim, u dalë edhe te tonë i kanë marrë rrogat si ai që ka punu shumë ma pak që u konë në vende ma t'lehta, si na knej rrogat i kanë pasë njisoj, benefitet prej ktuhit i kanë pasë njisoj krejt çdo send. Nuk ka pasë asnjë dallim, pos dallim ka pasë që shqiptarët janë konë në vende ma t'shtira.

Miniera si minierë osht' punë e rondë. Gjithmonë kanë thonë, "Buka e minatorëve i ka nontë kore". Ndaq thuj nontë, ndaq thuj 900, ndaq thuj 900, se ka vende që kanë punu, sot punojnë shumë të rrezikshme janë.

Anita Susuri: Për dikond që nuk e din, që s'ka hi kurrë brenda domethonë qysh osht' na tregoni? Çfarë ndjenje osht'? A osht' frikë?

Xhafer Peci: Miniera janë i ka afër dyqind kilometra punimin, rrugët të ndryshme në minierë horizontale, vertikale edhe krejt edhe gjithmonë ti në minierë ti je i kufizum n'tonë anët. Ti ki me pa me një dritë që nëse largohesh dikun e je vetëm, me t'u prish ajo dritë ti duhesh me u ulë dikund në një

qysh edhe me pritë me orë deri sa t'kalon dikush me t'marrë e me t'vazhdu, se aty mo ti asnji hap nuk mundesh me bo, nuk je i sigurtë me bo, nuk guxon asnji lëvizje me bo.

Osht' punë e rondë, osht' punë fshtirë, osht' punë shumë me përgjegjësi, një gabim i një udhëheqësi mundet me i kushtu me jetë dikujt. Në minierë sot mujm m'i pasë dhjetë tonë eksploziv. Aty duhet menaxhim i saktë. Vijnë shpesh aty na kontrollojnë depot KFOR-i, inspektorat e Prishtinës, inspektorat e punëve të brendshme i kontrollojnë depot. Domethonë, aty duhet një menaxhim i saktë, i sigurtë. Aty duhet librat të evidentohen mirë, sakt, pa problem.

Anita Susuri: Gjithmonë ka ekzistuar ajo që kanë thonë se “Trepça” ka punu ma shumë për vendet domethonë tjera në Jugosllavi se sa për zhvillimin e Kosovës. A i keni ditë ju ato edhe çka keni mendu? Ti çka ki mendu për këto?

Xhafer Peci: I kemi ditë ato parolla, i kemi ditë ato krejt edhe apat se apat jemi mundu diqysh me i rujt atë Kosovën me atë vllaznim-bashkimi që i kanë thonë në thojza ktyne herë m'i rue. Nuk jemi konë na ata që e kena prish punën. Na jemi konë të detyrum me reague, me lëvizë, me i mbrojt qato të drejta të pakta që nisen m'u marrë edhe qato edhe domethonë tash, “Jo s'ka nevojë fakulteti m'u msu shqip, por me msu krejt një gjuhë serbisht, me fol krejt një gjuhë ktu e atje”. Edhe shqiptarët qato kanë deshtë me i mbrojtë, qato pak që i kanë pasë. U duht me mbrojtë me gjak, me jetë, me hjek, me vuajtje, me gjithçka për me i rujt qato pak që jonë konë. Sigurisht edhe bota nuk kish intervenue pa konë t'bindun që shqiptarët veç të drejtat e veta po i lypin, nuk po lypin me i shkel kërkon.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: A po më tregon tash për momentin kur e keni kuptu që mo nuk po shkon kështu edhe ka ardhë deri te ajo që me bo diçka, me ngrit zanin. Qysh ka ardhë deri te qajo?

Xhafer Peci: Prej odave, prej odave e prej si nxanësa të shkollës t'mesme, si studenta u fol droja, “Don m'u bo qeshtu. Dojnë m'i marrë Kosovës t'drejta. Don m'u hek Universiteti i Prishtinës. Don m'u bo një gjuhë që me fol veç serbisht t'gjithë, m'u bo gjuhë zyrtare”. Edhe gjithmonë ajo u shku tu u rritë, tu e rritë dronë, tu e rritë frikën te na, derisa në një moment e mrrijti kulminacionin në vitin '81-shin edhe vazhdoi për knej edhe aty u pa qëllimisht që Serbia çka patë qëllim. Suprimimi i autonomisë të Kosovës, suprimimi i t'drejtave atje dhe faktikisht me bo, m'u bo gjuhë zyrtare serbishtja në krejt ku... edhe në Kosovë.

[cingron telefoni dhe zgjatet për ta ndalur]

E që për popullin tonë ka qenë e papranushme edhe e papranueshme. Edhe për fëminë ka qenë e papranushme që s'i ka ditë senet, se jo mo për tjerët.

Anita Susuri: Qajo ditë që keni marshu po m'doket i ka parapri grevës. Për çka ka qenë?

Xhafer Peci: I kena pasë dy marshe. E kena pasë marshin prej Stantërgu në Mitrovicë në Sallën “Minatori” jena tubu minatorë, studentë, nxanësa edhe aty u bisedu për rreziqet që po e presin dhe po i vijnë Kosovës. Bile m’kujtohet aty Xhafer Nuli, ka qenë, osht’ inxhinier i diplomum i elektros, ka qenë Drejtor i Elektro-Maqinerisë, foli atje kundër fjalimit të Sheshelit [Vojislav Šešelj]⁴ e tjetrit e tjetrit. Domethonë, për me, “Ftoj popullin me konë sy çelë, m’u konë të pregaditun me i mbrojt të drejtat e veta”.

Korab Krasniqi: Çka kanë qenë deklaratat e Sheshelit në atë kohë?

Xhafer Peci: Atëherë, tash për suprimimin e autonomisë të Kosovës, marrjen e t’drejtave t’shqiptarëve, m’u hek Universiteti, m’u fol, gjuha zyrtare m’u bo gjuha serbe edhe qito.

Anita Susuri: Pas asaj?

Xhafer Peci: Pas asaj tensionet, veç nisi ndamja. Tensionet kanë qenë evidente. Këta merrshin serbët instruksione gjithmonë prej atjehit, “Bonjani qeshtu, bonjani qiknej, prisheni qito, boni qito”. Nji punëtor i jonë se tash po kthehna mbrapa, qitu serb ka qenë edhe u shku u vesh n’tesha t’shqiptarëve në ato kohë edhe u shku i ka thy me çekiç vorret e serbëve. Qitu ka punu, ja di emrin e mbiemrin, nuk osht’ gjo sigurisht tash, s’e di s’jom i sigurtë. E ka nxon policia, ka thonë, “Kush je ti?” Ka thonë, “Jom Filani, djali i haxhisë, Filan Haxhisë” edhe tash ata e marrin e çojnë në stacion që i ka thy vorret e serbëve.

Tash t’u e çu policia dikush prej shqiptarëve e ka pa, i ka thonë atij atje, “Kako si Zhiviq?” Ata kthehen, thotë, “A je n’mend çka po flet?” Thotë, “Po ky Zhiviq Mlladeni, ky qeshtu osht’”. Thotë, “Qysh more po na e kena nxon n’filan vend?” E tani kur erdh këtu në punë tregojke, thojke, “M’i kanë dhonë qikaq pare edhe m’kanë thonë me shku me i thy vorret e serbëve edhe unë i kom marrë ato pare e kom shku i kom thy vorret”. Domethonë veç filloi ndasia, fillun me bo probleme tash në llogari të shqiptarëve që tash m’i metë shqiptarëve, me bo dame në prona të serbëve edhe me i mbet shqiptarëve.

Erdh marshi i lavdishëm për Prishtinë. Marsh ma i lavdishëm, marsh nuk di, me kajt njeri kur e mendon ato ditë.

Anita Susuri: Qysh u konë ajo ditë?

⁴ Vojislav Šešelj (1954-) është themeluesi i Partisë Radikale Serbe nacionaliste. Në 2003 ai u dorëzua në Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë (ICTY), ku u padit për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Në vitin 2016 ai u shfajësua për krimet.

Xhafer Peci: Ato ditë na jena tubu këtu nalt në sallë, në sallë ku u majt tubimi i punëtorëve, ndrrimi i parë, ndrrimi i tretë. Erdh drejtori teknik Ibush Januzi po ju flet punëtorëve. “Drejtor”, thotë, “ti po na flet”, thotë, “por a pe sheh ku po dojna me mbet na? Ku po don me mbet Kosova? Ku po don me mbet rinia e Kosovës? Çka po bohet me neve? A pe shihni qysh marum?” Edhe aty tash një moment jonë çu masa krejt edhe jonë dalë, “Hajdeni po shkojmë në Prishtinë” edhe jena nisë. Jena nisë t’u na u bashkangjitë tash edhe njesitë të tjera të “Trepçës”, jena nisë n’kamë. Na i kanë dikun, na i kanë pru autobusat, jena hipë edhe në autobusa se u blloku rruga krejt. Për mos me u blloku rruga autobusat. Deri dikun i nalën autobusat, i thamë, “Çelna derën!” Në kamë na jena nisë.

Te {tregon me duar}... qiko te Millosheva që osht’ na ka dalë Remzi Kolgeci përpara. Na ka fol, kemi thonë, “Jo na nuk kthehem edhe na kena me vazhdu knej anej”. Na kena vazhdu edhe u met n’mes të turrmësh edhe u shku me kerr anej për Podujevë ajo rruga që shkon me dalë te tregu i vjetër i kerreve {tregon me duar} e me shku në Prishtinë. Ai u shku atje sigurisht, na kena vazhdue. Te Gazimestani na kanë dalë Njesitë Speciale asfaltin e kanë bllokue. Na jena konë në rendet e para edhe s’e kom pa as policin qeshtu. Nuk kanë reagu, me gjasë kanë qenë shqiptarë nuk kanë reagu edhe na tash nuk kena deshtë as ata me i provokue, kena hi n’dy anët knej e knej {tregon me duar}. Ata jonë metë aty, na e kena vazhdu rrugën.

Asnji fjalë nuk ja u kena thonë e kena vazhdu rrugën. Në hymje të Prishtinës në anë të majtë aty atje përpyetë edhe bile bile ndoshta pak u mashtrum se patë vyjt me shku edhe te Komiteti aty. Atëherë kanë thonë u konë një Gjeneral Sreten Mirković [...] a s’di ku me ju bo presion ktyne për dorëheqje. Na jena hi në Sallë aty të Rinisë edhe u mush aty. Erdhëm tash na u mushëm krejt.

Anita Susuri: Në Boro Ramiz.

Xhafer Peci: Në Boro Ramiz. Nuk kish vend aty. Jonë ardh tash punëtorët prej Kishnice e Badovci e Hajvalie e krejt. Ata jonë ulë n’tokë, s’ka pasë vend këtu nalt. A po don tani rinia, gjithçka bre aty nalt. Erdh edhe Kaqusha Jashari aty. Ajo na priti mirë, na foli mirë. Na i kërkum, i tham që dorëheqje mos me dhonë kërkush në presion të kërkujt edhe n’dekshim tonë. “Jo”, tha, “na s’kemi me dhonë dorëheqje”. “Na po vijmë”, minatorët i kanë thonë, “Po vijmë edhe në Komitet atje”. “Jo s’keni nevojë, na... fjalët e juve jonë qito, përkrahja juve, knej anej”, që nuk dojshin m’u bo ma e madhe me gjasë.

Na jena kthy atë ditë qysh kena mujt, dikush n’kamë, dikush me na autobus, me naj kerr jena kthy për Mitrovicë. Jena shku në shpiat tona. Kohë e zyrtë, situatë e zyrtë, situatë sikur n’vorrim kur osht’. Tani...

Anita Susuri: A keni mendu që ka me pasë pasoja qajo për juve?

Xhafer Peci: More na ato pasojat te tona i murrem mbi veti, e ditëm pasojat, e ditën çdo send edhe apet se apet gjinja jonë konë n’gjendje me dhonë jetën, se jo burgun e jo tjerat. Edhe kadal-kadale

apet vazhdoi një punë t'u i ndrru atje-këtu drejtorat, prunën udhëheqësi t'dhunshme. I pagujshin ata atje me komuniku me neve, na s'komunikojshim me ta. Na komunikojshim ktu veç me punëtorë, punëtorët veç me neve, me ata hiç. Vazhdun qashtu deri në grevat t'minatorëve se veç edhe kulmi i Serbisë veç mrrijti te suprimimi i të drejtave t'shqiptarëve.

Atëherë erdh vakti 20 shkurt '89-tës, minatorët e ndrrimit t'parë u ngujun në minierë edhe tash u ardhë ndrrimi i dytë në minierë edhe aty mo nuk ka pasë kërkesa sindikale, kërkesa sociale, vetëm e vetëm krejt ka qenë kryekput kërkesa politike edhe njo prej pikave ka qenë ruajtja e autonomisë territoriale dhe hapësinore të Kosovës edhe qajo pikë i përfshijke te tona tjerat. Aty punëtorët tetë ditë e tetë netë nuk jonë dal prej miniere në horizontin e tetë me flejt në shkamb n'tokë nuk di qysh u konë.

Anita Susuri: E tash deshta diçka me pytë...

Xhafer Peci: Tetë ditë...

Anita Susuri: Qatë ditë që u marrë vendimi që po fillon greva, a u bo kjo si organizim? A u ditë ma heret a qysh?

Xhafer Peci: Kadal-kadale kjo u ditë që don me konë. Tash marshet u kryen u tregum atje edhe e dijsim që don me konë një organizim pak ma i madh, por kërkush me kërkon nuk folke që me u çelë, m'u ndi ato fjalë dikun jashtë. Nuk jonë ndi ato fjalë jashtë, nuk e kanë ditë 90, a 90 përqind t'jashtit që çka ka me ndodh. Në shpiat tona s'e kena diskutu shumë shumë aty, pa një periferi diçka. Ndodhi ajo ditë edhe na jena konë te tonë këtu. Jena pregadit, jena shku në minierë. Unë jom shku në horizontin e shtatë për t'parin herë edhe tash ishin konë shku do para meje edhe tash jonë mundu kishe hajt shkoni mi nxerr punëtorët edhe jonë shku, "Jo duhet me dal, keni mu smu, keni mu bo kështu", dikush a din pa dijeni.

Shkova unë edhe po ju foli atyne punëtorëve edhe po ju thom, "Jo bre, as s'ka me... na kena me luftu për t'drejta tona, as s'ka me vdek kërkush po kena me luftu për t'drejtat tona deri sa t'plotësohen ato, nuk jemi kundër kërkujt, nuk jemi me shkel kërkon por pi lypim t'drejtat tona". Edhe një punëtor prej t'vjetërve thotë, "Eu bre hallall t'koftë se patën me na tranu aty". Thom, "Jo, jo tranum s'ka por kjo punë ka me vazhdu" edhe shumica e kolegëve t'mi qashtu nëpër horizonte i kanë thonë që kjo u nis për qito, për t'drejtat tona, me i ru qito të drejta që i kemi, mi ru Kosovën, mi ru Universitetin...

[cingron telefoni dhe zgjatet për ta ndalur]

Edhe me i lyp t'drejtat tona. Atëherë u bo aty një Këshill grevist. Kena komuniku atje, kena shku kohë pas kohe në minierë e delegacionet tani mo t'panumërta edhe njo prej tyne tani kenë edhe dorëheqjet e këtyne treve që kenë edhe...

Korab Krasniqi: Dorëheqjet e...

Xhevdet Peci: Mas tetë dite... Rrahman Morinës...

Korab Krasniqi: Rrahman Morinës.

Xhevdet Peci: Hysamedin Azemit edhe Ali Shukriut.

Korab Krasniqi: Pse e keni kërku dorëheqjen?

Xhevdet Peci: Na e kena kërku se na u ka nga që ata ma s'shumti po komunikojnë me udhëheqsinë serbe dhe po i pranojnë tana kushtet e udhëheqsisë serbe edhe urdhnesat e tyne ata i kanë pru me i instalu në Kosovë edhe na tash ata tre. Jonë konë n'gjendje të tmerrshme në ato kohë.

Anita Susuri: A je konë ti nonstop në horizontin e tetë?

Xhevdet Peci: Jo, jena konë n'tana horizontet, n'tetin e t'nontin. Dalshim ktu nalt e merrshim naj delegacion, shkojshin, por paraprakisht ju thojshim, "Osht' qiky delegacion. A pe pranoni a jo? Jo, jo. Po, po". Shkojshim me ta i përcjellshim, dalshim e qitshim delegacionin në sipërfaqe, vazhdojshim. Ardhshin njerëz tyrlifare, ardhshin ndihma tyrlifare, ardhshin ushqim. A po don pare? A po don lira? A po don... dikush ni fukara e kish pru ni lopë e kish lidhë qaty.

Për minatorë *pai* {onomatope} ma shtirë, ma krejt... Edhe e prunën tash qysh e prunën edhe i tradhëtun minatorët. Me leje, me letër tre zarfa me vule t'kuqe të Komitetit edhe u lexun para punëtorëve që këta tre kanë dhonë dorëheqje qeshtu. Dulen punëtorët por u duht m'i qitë punëtorët n'mramje n'terr për arsye se mos me i hup t'pamunit mi qitë ditën. Natën plot salla qatje u konë {tregon me duar} i kanë hjek karriket, jonë konë në shtretër t'smutë njerëzit prej atyhit.

[Këtu ndërprehet intervista]

I qitëm punëtorët, filloi tani aksioni kundër minatorëve, u burgos ai, u burgosën punëtorët. E tash u konë interesant, u konë nifarë Elheme Kelmendi gjykatëse, u konë edhe knej serbët. Kush u shku te Elhemja i ka pasë një muj ditë burg, kush u shku te këta dy-tre-katër. Ajo tona ligjet i ka shkel veç me ju ndihmu punëtorëve, Elheme Kelmendi... Edhe shkun gjinja n'burg. Masanej tani i murren edhe Aziz Abrashin, i murrën edhe Burhan Kavajën, e murrën Azem Vllasin e i murrën edhe këta tjerët katërmbdhjetë a sa jonë konë ata n'burg edhe ata po osht' interesant që kanë qenë shumë, shumë t'bashkum n'burg, kush njoni-tjetrin s'e ka akuzu për kurgjo, s'e ka akuzu konin për kurgjo. Punëtorët knej thojshin, "Na e kena organizu, jo ata".

Anita Susuri: E ata qysh i kanë zgjedh ata? A veç qysh ja u ka marrë menja?

Xhafer Nuli: Epo tash qëllimi ishte me i mshu n'kry asaj pune me i mshu e në krye të te tonave ishte Aziz Abrashi atëherë, ish njeri i zoti. Masi dulen minatorët, metën minatorët atje në Leposaviq, hinen veç një troh atje, shkoj Aziz Abrashi me sekretarin e vet, bile kurrë s'e harroj ke si shihovinë e ja majke qadrën. Hallall i koftë nuk ju tremb Aziz Abrashit syri prej kërkujt edhe tha, "Unë për juve s'nij hiç", tha. "Mu m'kanë zgjedh", tha, "shumica e punëtorëve. Për juve nuk du me ni hiç" edhe nuk ju tremb syni Aziz Abrashit atëherë.

I burgosën. U bo edhe greva tani dy-tri ditëshe në horizontin e tetë. Tri ditë e tri netë ata gjinë kanë nejt me një tegëll kryp edhe tash pomparët u dashtë me i lshu në horizontin e njimbdhjetë, në horizontin e nontë edhe në horizontin e pestë edhe i kanë kontrollu mos po marrin bukë me ju çu atyne.

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Ato tetë ditë domethonë sa ka qenë greva çka keni pa ju? Çka ndodh me minatorët, me njerëzit që kanë ardhë?

Xhafer Peci: Ma fshtirë se me përshkru atë gjendje nuk ka. Nuk e di, kur ti gjonë njeri fjalët maksimale m'i përshkru, hala mandej ka vend për me i përshkru ato greva qysh kanë fillu, çka ka ndodh, çfarë shtuate u konë edhe qysh u konë gjendja shëndetësore e njerëzve osht', osht' nuk e di kush kish mujt me përshkru atë gjendje qysh u konë atëherë. Fillun me ndrrimin e parë, erdh ndrrimi i dytë, erdh ndrrimi i tretë, erdhen invalidat në minierë, familjarët, fëmija, tjerët dojshin me ditë gjendjen e prindit të tyne, vllaut të tyne, pjesëtarit të familjës të tyne. Çka u bo? Çka po bohet? Çka po marohet? Ardhshin delegacione, gjina të lodhun të rraskapitun qysh po i qet në televizion bile pak po m'doken. Thotë dikush, "Ku me ditë qysh e kanë hujdisë?" Edhe pak po m'doket qysh po përshkruhet gjendja, por s'i kanë qitë do t'smutë. U smujshin u duke me qitë njerin ka m'u bo si stacionarë. U shnoshke, i çelke sytë një trohë s'mujsh me çu kërka, shkojke apet në minierë.

U konë gjendje që m'u kajke mu si me pasë vdek naj njeri, nuk e di çka ish bo aty katastrofë, noshta ish bo menjherë me eksplodu me ata gjinë. Ata jonë konë në gjendje vetën me flijue në ato kohë në minierë, ose knej ose knej u konë pyetje, s'ka pasë aty zgjidhje t'mesme mo. Nuk ka pasë mo, ose dorëheqje krejt ose qata gjinë mu flijue krejt, nuk ka pasë zgjidhje t'mesme aty. Ekipet mjekësore u duht me ardhë. A po don kokrra t'qetësimit? A po don kokrra tylyfare? A po don intervenime? Në kreveta atje të njerëzve të smutë u çojshin, shkojshin në minierë apet, qashtu u smujshin apet.

Ardhshin delegacione, folshin edhe mos me harru aksioni i pajtimit të gjaqeve ka fillu prej horizontit të tetë. Aty jonë pajtu dy familje e u qitë lajmi me vazhdu. Kanë vazhdue, ka pasë jehonë ai aksion i tyre aty edhe punëtorët i kanë pasë kërkesate veta qysh e përsëritëm, qysh e cekëm kryekput politike. Ruajta njo prej pikave, ruajtja e autonomisë hapësinore edhe territoriale të Kosovës. Ai e ka përfshi tani te tona tjerat i ka përfshi edhe këta nuk kenë në gjendje, s'kanë deshtë serbët me thonë, "Na

dojna me konë t'barabartë me shqiptarë". Atëherë gjithherë jonë konsideru si njerëz të dorës t'dytë a të tretë a, "Shkruji ti t'drejta atyne".

Kena pasë tubime qitu në sallë atje. Erdhen delegacioni prej Serbisë, prej komitetit të Serbisë, prej komitetit tonë prej Prishtine edhe me na i spjegu neve ndryshimet kushtetuese që jonë t'mira, jonë qështu me na i zbukuru neve. Na i tham, "Po ndryshime kushtetuese, por le te bon gjithkush ndryshimet kushtetuese për veti. Na e punojmë për veti qysh t'na konvenon... p'e lyp vendi jonë. Ju për veti, ai për veti, ai për veti". E ashtu nuk u bojke, ish qëllimi i tyne tjetërkun. Na thojshin, "Ja na ndryshe nuk pranojmë, por ka ndryshime për me u ndryshu gjendja ekonomike e krejt, por gjithkush ndryshimet kushtetuese me i bo për veti, gjithkush me ja përshtat vendit t'vet ndryshimet kushtetuese".

Aty tani shkoi puna tu u dhez edhe qashtu fillun ato edhe qashtu met puna. A grevat, gjithmonë u konë ai Këshilli grevist, i kanë ngu si me konë robtë e shpisë. Osht' për çudi qysh ka funksionu ajo grevë, ai këshill atje kujt çka i ka thonë, "Ti qito, ti qito, ti qitu, ti qitu". Ajo u konë perfekt organizim, perfekt organizim në ato vende atje edhe qashtu.

Anita Susuri: Kur keni, domethonë kur ka ardhë lajmi që paskan dhonë dorëheqje qysh u prit prej minatorëve?

Xhevdet Peci: Jena gzu te tonë, ma s'pari jena gzu që po pshton jeta, po shpëtohet jeta e minatorëve. Tu u nisë prej qatytit po eliminohen shtyllat e Serbisë që jonë në Kosovë edhe po fillon një jetë pak ma ndryshe për shqiptarët, por ajo masanej nuk ndodhi. Hysamedin Azemi nuk u kthy. "Kom dhonë dorëheqje", tha "edhe mo kurrë s'kthehna. E ka lyp populli, qe ku osht' dorëheqja". Ata dy [Ali Shukriu dhe Rahman Morina] jonë kthy edhe jonë kthye edhe qashtu edhe tani u bonë ato burgosje.

Tani erdh 8 gushti 1990, neve na përjashtun prej pune. Na përjashtu prej pune vetëm e vetëm pse na i kena mbrojt të drejtat e shqiptarëve, vetëm e vetëm pse e kena mbrojt Universitetin tonë, gjuhën tonë, udhëheqsinë tonë, apsolut tjetër s'ka pasë. Na përjashtun prej pune. Kena nejt pa punë, në kushte... s'i kena pasë kushtet e mira edhe kur jena konë n'punë, por tani pa punë. I kanë qitë vetëm e vetëm që punëtorët m'u rreziku për bukë edhe që me shku me ju nënshtru Serbisë me i thonë, "Ti, veç qysh t'thush ti, veç t'kom une bukë n'shpi teme". Falë Zotit edhe organizimit t'shqiptarëve edhe organizohet familjet tjera "Familja e mban familjen" edhe i kanë pshtu familjet e minatorëve, familjet e Mitrovicës i kanë pshtu, se Mitrovica u konë e varun krejt prej Kombinatit. Ai u mshel, ata jonë konë t'rrezikum. Akcioni "Familja e mban familjen" e ka pshtue Mitrovicën.

Anita Susuri: Qatë ditë kur domethonë ju kanë largu prej punës a ka pasë naj revoltë a qysh ka qenë qajo ditë? A ka pasë polici?

Xhafer Peci: Atë ditë 8 qershori ka qenë, jonë ardhë me autobusë. Kur jom dalë në qatë kthesen atje {tregon me dorë} t'u bisedu me një kolegë jom konë, e kom pa këtu krejt kaltërt.

Anita Susuri: Me policë.

Xhafer Peci: Me policë, me automjete t'policisë, krejt këtu u konë kaltërt krejt. Jena zhdryp aty edhe aty u ditën masa krejt. Na nuk deshtëm asnjë me hi me punu me ato masa të tyne edhe aty ka majtë një fjalim Haxhi Januzi, u konë inxhinier i diplomum i xehtarisë i ndjeri nuk o në jetë edhe i ka spjegu qëndrimet tona edhe Xhafer Nuli një revoltë aty foli edhe aty edhe na jena nisë te poshtë, e pamë që për shqiptarë mo s'ka. Ata tani kanë vazhdu, kanë punue. Herë do merr do që jonë konë t'burgosun prej Bosne, do knej do anej, por ka punu, kanë bo një vjedhje të xehes qysh thojnë në ato termet shkencore edhe kanë punu deri sa u hi KFOR-i.

Na tani jena kthy me 22 dhjetor 1999, t'parën ditë n'ditë dimri jena ardh n'kamë qitu përpjetë edhe jena hi qitu n'minierë. Me gjasë me autobлинд serbët i kanë qitë në tjetrën anë edhe i kanë nisë te poshtë. Na atëherë, një organizim sindikal e kena shkru gjithkush, nënshkru ka një fletë që na jena ngjendje me punu me të gjithë edhe serb edhe romë edhe krejt me ata njerëz që nuk i kanë duart e përgjakta edhe sot ato dokumente jonë dikun, ku jonë nuk e di. E kena nënshkru na te tonë, "Me ata që nuk i kanë duart e përgjakta", por asi për fatkeq s'ka pasë edhe qashtu u metë.

Anita Susuri: Deshta edhe m'u ndërlidhë pak me familjen e juv se është që thatë edhe ju e vështirë si, domethonë si profesion është i vështirë ky që po e boni. Fëmijët e juv, bashkëshortje, familja a jonë shqetsu sa herë që keni shku në punë? A jeni ju?

Xhafer Peci: Paj (buzëqesh) atëherë nonën e kom pasë, vllaun, njonin vlla jashtë, motra edhe shoqja.

Anita Susuri: Po.

Xhafer Peci: Paj, gjithmonë qysh kanë thonë populli, "Me vesh n'krah çka po nihet. A erdhe? Shyqyr që erdhe. A erdhe? Shyqyr që erdhe, shyqyr që erdhe". Hupshin gjinja rrugës, i marrshin, i malltretojshin, i rrehshin, i lshojshin natën. Çka kanë deshtë kanë bo. Çka kanë deshtë kanë bo. Unë një herë, një polic e nali njonën edhe po i thotë, tha, "Po a e din ti që unë mundna me bo çka t'du me ty?" Domethonë durët e lira, bo çka t'dush edhe qashtu. Se edhe tona familjet e kanë pasë atë shqetësim.

Korab Krasniqi: A muj edhe një pyetje e pata. Njona prej pikave si kërkesë që e kena pasë gjatë grevës ka qenë me taku Millosheviqin [Slobodan Milošević]⁵ edhe Stipe Shuvarin [Stipe Šuvar]⁶.

⁵ Slobodan Milošević (1941-2006), udhëheqësi Jugosllav ngritja e të cilit në pushtet filloi në 1987, kur në Lidhjen Komuniste të Plenumit të Jugosllavisë ai përqafoi kauzën e nacionalistëve serbë të Kosovës dhe menjëherë më pas u bë President i Serbisë dhe revokoi autonominë e Kosovës.

⁶ Stipe Šuvar (1936-2004) ishte një politikan dhe sociolog kroat i cili konsiderohej të ketë qenë një nga politikanët më me ndikim komunist në Lidhjen e Komunistëve të Kroacisë në Republikën Socialiste të Kroacisë gjatë Jugosllavisë dhe më vonë në Kroacinë moderne.

Xhafer Peci: Po, po.

Anita Susuri: Me ardh.

Korab Krasniqi: Çka keni dashtë m'i thonë?

Xhafer Peci: Po, kanë deshtë minatorët me i thonë n'sy të dyve që minatorët po dojnë, p'i kërkojnë të drejtat e shqiptarëve. Po kërkojnë që shqiptarët po kërkojnë m'u konë të barabartë me popujt tjerë. Po dojmë që Kosova m'u konë e barabartë edhe me njësitë tjera. Po dojmë që autonomia e Kosovës mos m'u suprimu. Atëherë Millosheviqi u ikë në atë kohë, qatë kohë u shku në KEK qatë ditë, ndërsa Stipe Shuvari u ardhë këtu edhe jonë ato fjalimet që jonë të inçizume çka ka thonë Shuvari, çka i kanë thonë këta Shuvarit minatorët e jonë ato krejt e çka s'ka premtu Shuvari kurgjo aty edhe qashtu.

[Këtu ndërprehet intervista]

Korab Krasniqi: Edhe një pyetje për fund nëse muj, po mendoj prej anës teme, në prill të '87-tës vjen Millosheviqi në Fushë Kosovë.

Xhafer Peci: Po.

Korab Krasniqi: Mandej në '89 për Vidovdan⁷ në Gazimestan edhe ai mbanë fjalime në të dyja rastet. Qysh reflekton qiky veprim te minatorët? Qysh i shihni ju qito dy ngjarje?

Xhafer Peci: Qysh u konë ma s'keqti. Na në Gazimestan, ajo u konë thirrje për luftë.

Anita susuri: Po.

Xhafer Peci: Ajo u konë thirrje për luftë kundër shqiptarëve. Ajo u konë për me i shkel shqiptarët për toke. Kështu me i kallxu ma s'thjeshti ai u konë, fjalimi i tij u konë për luftë. Ai u konë për me i shti shqiptarët në çizme të tyne.

Korab Krasniqi: Çka keni diskutu ju ndërmjet veti masi që u konë?

Xhafer Peci: Gjithçka. Kena diskutu edhe kështu edhe kështu edhe kështu edhe kështu, krejt për rezistencë, krejt për rezistencë.

⁷ Vidovdan është një festë kombëtare dhe fetare serbe. Festohet më 28 qershor ose 15 qershor sipas kalendarit Julian. Kisha Serbe e cakton atë si ditën përkujtimore të Shën Princit Lazar dhe martirëve serbë të rënë gjatë Betejës së Kosovës kundër Perandorisë Osmane më 15 qershor 1389.

Korab Krasniqi: A ka ndiku fjalimi i Millosheviqit, nejtë fjalimi vjen pak ma vonë mas grevave, por në mobilizimin e matutjeshëm?

Xhafer Peci: Çdo dhunë, çdo thirrje e tyne kundër Kosovës shqiptarët veç i ka bashkue, veç i ka bashkue ka një kërkesë e vetme, kah një kërkesë e vetme, “Kosova njësi e barabartë në Federatën apo në Konfederatën jugosllave edhe nëse vjen deri te ndarja Kosova me vendos për veti”.

Korab Krasniqi: Pse pe qun edhe Federatë edhe Konfederatë?

Xhafer Peci: Epo se mendojshin tash Sllovenia, Kroacia m’u nda diqysh anej, kjo pjesë me na ra knej si një lloj Konfederate atëherë u folke edhe atëherë ose edhe Federata sikur që u konë atëherë tona njësitë e barabarta edhe na kena deshtë me konë njësi t’barabarta me njësitë tjera pa e cënu lirinë e askujt.

Anita Susuri: Në vitet e ‘90-ta kur kur ke mbet pa punë me çka je marrë? Qysh ka vazhdu çdo send?

Xhafer Peci: Në vitet e ‘90-ta unë për fat ma s’pari iu kena kushtue kursimit, maksimal kështu, kursimit maksimal. E mandej e kena pasë një vlla në Holandë edhe sikur orën kur e len me t’kurdis me të zgju një kohë t’caktume, qashtu edhe ai na u ka gjind në atë kohën ma t’shtirën edhe nuk kena pasë nevojë as me lyp ndihma as me shku me bo konkurencë dikun edhe kena. Kursimin e kena pasë n’dorë edhe sot e atë ditë, por tash m’u prej kur jom konë në shkollë m’ka mbet kursimi se si njeri, familje e varfun kurrë s’i kom lyp babës tem pare për n’shkollë, pos për një mujore edhe për një libër, tjetër kfit u konë, kfit u konë tjetër.

Anita Susuri: Domethonë për vitet e ‘90-ta ka qenë fshtirë por...

Xhafer Peci: Tani na jemi gjind qashtu me pak pare t’vllaut, me kursim na ja kena dalë edhe nuk jena konë, jena konë pak anëtar. U nis aksioni familja e mban familjen edhe ja nisen me i majt njerëzit. Një numër i minatorëve edhe ata dulen jashtë edhe njimoshin edhe ata dikujt dikujt këtu, kryesore që minatorët nuk ju nënshtrunë kërkujt. U bojke aksioni atje në Rahovec me vjeljen e rrushit, i marrshin minatorët i thojshin hajdi. I majshin, ju dhajshin pare ma shumë se që kanë punu ata gjithsesi, e ju dhojshin bukë e ju dhojshin gjithçka e tani u vllaznojshin edhe një familje me një familje dikun e qashtu.

Ka pasë raste që ka thonë dikush unë s’kom nevojë me m’ndihmu kërkush veç po kom qef me pasë një familje sa m’i njoftë dikun në atë komunë anë atë tjetrën a në atë tjetrën, por kanë qenë do ditë të t’tmerit, të hjekës edhe t’lavdisë t’shqiptarëve. Me kon jena taku, “O çka i ki punët bre? A po ki bukë?” Kurgjo ma andej, “A po ki bukë?” “Po valla”, “E shyqyr Zotit. Po Filani, a ka bukë? Tjetri a ka bukë?” “Valla po m’doket që ka”, “E shyqyr”. Jonë konë gjinja njëfarë t’bashkum. E kanë pasë njëfarë krenarie që po i reziston pushtetit t’huj edhe veç ka pasë bukë, as s’u konë për me thonë për veshë a mathë, kafe a çaj veç buka edhe rezistenca knej edhe qashtu u konë.

Anita Susuri: E lufta qysh ju ka zatet?

Xhafer Peci: Lufta nuk na ka zatet, kështu po mendoj nga familja ligsht, atëherë pare kena pasë, por ma çoi Zoti ndaq thuji një budallak, ndaq thuj një menje që ju thojsha të tjerëve, “Mos kqyr bre me dalë jashtë. Për konë po lufton UÇK-ja? UÇK-ja duhet me nejt në mesin tonë e me hangër bukë n’mesin tonë se nëse na tetonë shkojmë atëherë ku jetë?” Por qeshtu rreziku. Thashë edhe tjetër thashë, “Mos, nuk u duht me mendu që m’u bombardu Beogradi e na mos me na qitë. Nuk u konë”.

E kisha vllaun, ishim në mal, ishim në mal anej. Shkojshim n’mal, ardhshim natën deri në gjys të Mitrovicës, kqyrshim situata diçka, u kthejshim, i thojshim kem valla qetu, ish qeshtu e tjetri qeshtu e tjetri qashtu. Tonë kohën aq sa kena nejt i percillshëm njerëzit, “Valla kom nevojë me shku qitu”, “Hajde bre qe po t’çoj deri qiko”. Tjetri knej e anej, por jena konë kryesorja n’mal, bukë sa kena pasë kena pasë edhe kena mbijetu me qata bukë.

Fëminë i kishim një shpi në Mitrovicë hala s’i kanë pasë qitë qaty prej shpiave. Shkojshim natën, “A jeni rahat? A jeni mirë? A ka diçka?” “Jo”. Na shkojshim naltë në mal kqyrshim u enëshëm, bojshim, por edhe aty kena thonë, s’dijshim kush po pshton, por thojshim, “Lumi ai që pshton e konë te zatet ka m’u konë i knaqun kur te takon dikun me fol e me i marrë ngryk e krejt”, por interesi pak na i ndryshoi punët.

Anita Susuri: Domethon,ë ju nuk jeni largu prej Kosovës.

Xhafer Peci: Jo, nuk jena largu.

Anita Susuri: As familja ju.

Xhafer Peci: As hiç, as familja, as unë, as vllau, as krejt këtu kena nejt,

Anita Susuri: A ka qenë ndonjë rast rrezik shumë i madh?

Xhafer Peci: Valla një katër pesë herë n’tubë na ka ra granada. Fati nuk di çka atje, fati jena pshtu edhe qysh po i nijke me t’ra ngat ajo pjesa e granadës qysh po bike, qysh po fishklojke me t’kalu ngat ish shumë interesant, shumë interesant. Por e kena ditë që osht’ luftë. S’kena prit ma mirë prej tyne. “O valla e vrajti. E pse e vrajti?” Nuk kom prit unë që s’e vret, nuk kom pritë ma mirë edhe ajo m’ka dhonë pak edhe një qëndrim edhe një fuqi. Nuk kom pritë ma mirë valla, “E bonën kto e ato”. “Kqyre mos prit ma mirë. Mos pritni ma mirë prej tyne. Këta jonë ardhë për qito edhe tash na jena për qita, dy ideale të kundërta cila t’fiton jemi qitu edhe fund”. Veç i thojsha vllaun, “Kur na bombardojshin mos u unxh ngat meje. Unxhu qatje ti edhe rri se ti s’din ku bjen granada a knej a anej. Unxhu qitu rri kqyre”.

Anita Susuri: Tani erdh edhe çlirimi. Qysh e keni pritë qatë ditë?

Xhafer Peci: Shkojshim në luftë ka shpia, beso nuk u kthejshim me kqyr n'shpi, e paska kulmin e krejt edhe kurrë nuk kena thonë deri në javën e fundit kom thonë, T'kish me pshtu shpia se veq robtë, njerëzit t'kishin me pshtue, kryet e njerëzve". Qatë javën e fundit kom thonë, "T'kish me pshtu shpia, kurgjo hiç ma anej". Çlirimin, *pai* {onomatope}, po konë e takojshë, s'mujke njeri vajin... Atje e takojshë, "O a keni bukë? Çka i keni punët? A keni kund ku me shti kryet m'u strehue?" Qato fjalë kanë dominu gjithkund, "A keni kund ku strehoeni? A keni vend? A keni kond? A i keni krejt?"

Na e kena pasë një familje t'nji minatori, bile punëtor i jemi u konë këtu me gjashtë djem u konë n'shpi tonë edhe tash plaka jemi, gruja, na plaka, na katunarët plaka i thojmë (buzëqesh) edhe i bojke ka shtatë, tetë bukë i piqke ja u çojke atyne atje edhe për neve aty... Edhe tash kur na qitën aty prej shpiave po më thotë ai, "Xhafer çka me bo?" Thom, "Vallahi nuk di as për ty as për veti n'dorë të Zotit". Thom, "Qe një çelës qitu edhe hin mrenda, t'qiti udha s'të qiti udha s'di" edhe nuk dijshe kërkujt m'i thonë kurgjo se me i thonë diçka njeri mos p'i qet n'kurth, nuk kishe, s'dijshe kujt çka me i thonë. Po qashtu edhe ato e kena pasë një krenari që po rezistojmë ndaj dikuj.

Anita Susuri: Ju m'thatë që mas luftës keni ardhë këtu ,domethonë në minierë edhe i keni pa tu u largu serbët.

Xhafer Peci: Kanë thonë, une s'i kom pa për veti.

Anita Susuri: S'i ki pa.

Xhafer Peci: Kanë thonë që me autobлинд i kanë largu serbët ne një tjetër hymje jonë shku.

Anita Susuri: E kur ke ardh ti qysh t'u ka dokë?

Xhafer Peci: Na jena ardh një 202 vetë. Me 22 dhjetor të '99-tës jena ardhë këtu edhe minierën e kena gjetë n'buzë katastrofe, n'buzë t'përmytjes me ujë. Jonë konë diku afër një milion metra kub ujë. Sistemi i pompimit ka qenë jashtë funksionit. Jena hi atë ditë jena lshu në minierë çfarë rreziku se ka mujt me qenë e minume a diçka. Jena lshu me drejtorin e atëherëshëm Burhan Kavaja na do inxhiniera, jena lshu deri në horizontin e njëmbëdhjetë. Jena shku një vend, një pikë e kena kqyrë edhe krejt e ditëm qysh o gjendja, si e kena kqyrë atë pikë e ditëm qysh o gjendja.

Jena dalë edhe kena fillu. Nuk ka kqyr kush a o inxhinier, a o punëtor a o krejt veç te tonë kena punu njisoj, vetëm e vetëm me shpëtu minierën. U konë punë, as s'e ka kqyr kush orarin e punës, as kohën e punës, veç me punu. A ka punu dhjetë orë, a dymbëdhjetë orë, a e ka vazhdu në t'parën a t'dytën kena punu, jena dalë. Ai dimri i '99-tës ka qenë dimër i rondë. I kena la dur të, sytë me borë. Jena shku na ka prit një autobus, jena shku prej shpie, jena ushqy qysh kena mujt diqysh kush çka na ka pru. Jonë

mundu tjerët t'hujt, "Hajt se s'ka gajle, se na ju bijmë maqina krejt", u mundun noshta m'i përmbytë minierat, por na nuk i lejum. Edhe sot e atë ditë falë qatyne njerëzve miniera osht' në gjendje pune. Jonë riparu, jonë hjek një minion metër kub ujë prej miniere. U rregullu, u çelë, jonë çelë kanalizantet.

Punohet tash gjithkund, punohet. Hijnë punëtorët shkojmë na pa problem. Pos rreziku që osht' i minierës i përgjithshëm, tjera nuk ka. E kemi kontrollu edhe atëherë minierën, s'ka lonë kurgjo, s'ka eksploziv dikun të gjujtun a diçka. Diku ku ka pasë i kena hjek, i kena eliminue edhe miniera u siguru për punë.

Anita Susuri: Sot qysh po shkon puna?

Xhafer Peci: Edhe miniera sot është përsëri në gjendje pune është në gjendje stabile. Prej mas lufte e deri sot i kemi dy lëndime vdekjeprurëse që munden m'u livdu, tetonë munden m'u livdue edhe tash o miniera në gjendje pune. Objektet kapitale jonë t'rujtuna edhe qashtu.

Anita Susuri: Zoti Xhafer nëse keni edhe diçka me shtu për fund, nëse keni harru ose doni me përmend?

Xhafer Peci: Miniera krejt qikjo zona veri-lindore deri te kufini është e mineralizume me qitë xehe. Ka edhe ndoshta po ja afro, kalon 50 milionë tonë xehe që duhen mu konë n'qito rajone ksajde, por edhe ma shumë. Aty duhet një interesim i shoqnisë tonë që këntë pasuni me kthy në të mira materiale, por tek e fundi pasunia është këtu. Kur t'dojmë nesër masnesër pasunia osht' këtu, këto vetëm duhet me rue me ligje mos me na e marrë kush n'bisedime. Atëherë, mu po m'doket që Ahtisari [Martti Ahtisaari]⁸ kur ka thonë, "Pasunia çka o mrenda territorit të Kosovës i takon popullit të Kosovës" edhe ajo osht' një thanje e madhe. Tash na duhet me i mbrojtë pasunitë tona.

Anita Susuri: Faleminderit shumë zoti Xhafer.

Xhafer Peci: Po ju falenderoj juve ma s'shumti juve jo veten, jo kërkond veç juve që jeni të interesum me bo një asi programi, me shkru diçka me mbetë diçka e shkrume.

⁸ Martti Oiva Kalevi Ahtisaari (1937-) është një politikan finlandez, Presidenti i dhjetë i Finlandës (1994–2000). Ahtisaari ishte një i dërguar special i Kombeve të Bashkuara për Kosovën, i ngarkuar për organizimin e negociatave të procesit të statusit të Kosovës.